



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: _____.____.2022

Nr:

PROJEKTVENDIM
PËR
RREGULLAT PËR REGJISTRIMIN E ZGJEDHËSVE NGA JASHTË VENDIT PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, paragrafi 1, shkronja “dh”, nenit 24, nenit 25, nenit 46, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator,

VENDOSI:

- 1) Çdo shtetas shqiptar me të drejtë vote, me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për një periudhë më të gjatë se tre muaj pa ndërprerje ose për një periudhë më të gjatë se gjashtë muaj, në një vit kalendarik sipas parashikimeve në dispozitat e Ligjit Nr. 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të republikës së shqipërisë”, nga këtu e vijim në këtë vendim i referuar si “votues nga jashtë”, ka të drejtë të votojë atje ku ai ka vendbanimin e tij, pasi të ketë shprehur vullnetin për të votuar, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.
- 2) Procedura për paraqitjen e kërkesave për regjistrimin e votuesve nga jashtë fillon jo më vonë se 15 ditë nga data e shpalljes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës për zgjedhjet për Kuvendin dhe përfundon jo më vonë se 60 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

- 3) Kërkesa për regjistrim bëhet nga vetë votuesi nga jashtë, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të tij, ose nëpërmjet një aplikacioni të instalueshëm në pajisje të ndryshme inteligjente, i miratuar nga KQZ.
- 4) Votuesi nga jashtë që kërkon të regjistrohet duhet të plotësojë të dhënat që i kërkohen në formularin përkatës elektronik i cili i vihet në dispozicion sipas pikës 3 të këtij vendimi.
- 5) Formulari përkatës elektronik përmban të dhëna mbi: emrin, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, numrin personal të identifikimit, adresën e vendbanimit të përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, një numër telefoni të lëvizshëm funksional, një adresë e-mail të vlefshme. Zgjedhësi nga jashtë duhet t'i bashkangjisi (ngarkojë) të dhënave të mësipërme edhe një foto të dokumentit identifikues të tij të lëshuar nga shteti shqiptar dhe/ose nga shteti ku ai banon.
- 6) Komisioneri nëpërmjet administratës së KQZ vërteton vullnetin e votuesit nga jashtë për tu regjistruar, nëpërmjet identifikimit biometrik të tij, ose nëpërmjet një mënyre tjetër me mjete elektronike, e cila sigurohet plotësisht mbi vërtetësinë e identitetit të votuesit që ka bërë kërkesën për regjistrimin. Në rast të mosfunksionimit për arsye teknike të sistemeve dhe pajisjeve të teknologjisë së informacionit procedurat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit do të zhvillohen sipas Urdhërit të dalë për këtë qëllim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i cili publikohet dhe konsultohet publikisht në faqen zyrtare të internetit të KQZ.
- 7) KQZ ka të drejtën e verifikimit të përputhshmërisë së të dhënave të formularit përkatës elektronik të plotësuar nga votuesi nga jashtë me të dhënat e tij në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC). Nëse votuesi nga jashtë nuk ka deklaruar vendbanimin e tij në përputhje me përcaktimet e ligjit 14/2016 “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë” dhe akteve nën ligjore të nxjerra në zbatim të tij ose të dhënat e formularit përkatës elektronik nuk përputhen me ato të RKGjC, atëherë kërkesa për regjistrim refuzohet. Në këtë rast, votuesi nga jashtë njoftohet për refuzimin nëpërmjet e-mail, ose mesazhit telefonik, ose automatikisht pas aplikimit për regjistrim nëpërmjet faqes zyrtare së internetit të KQZ, ose aplikacionit përkatës. Votuesi të cilit i është refuzuar kërkesa për regjistrim, ka të drejtën të ri-aplikojë duke respektuar afatet e përcaktuara në këtë vendim.

- 8) KQZ përfshin në një listë të posaçme emrat dhe të dhënat e tjera identifikuese të votuesve nga jashtë të cilëve ju është pranuar kërkesa për tu regjistruar për të votuar atje ku ata kanë vendbanimin jashtë vendit, këtej e tutje referuar si Indeksi i Votuesve nga Jashtë (IVJ).
- 9) Me përjashtim të zhvillimit për herë të parë të votimit nga jashtë vendit, në zgjedhjet pasardhëse për Kuvendin e në vijim, KQZ do duhet që në ndërveprim me DPGjC të përditësojë adresat jashtë vendit të deklaruara nga votuesit nga jashtë të cilët figurojnë ndërkohë të regjistruar në IVJ. Në çdo rast, në zbatim të parashikimeve të Kodit Zgjedhor këta zgjedhës do duhet të shprehin vullnetin për të ushtruar të drejtën e votimit, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim, pa pasur nevojë për të dhënë sërish të dhëna apo dokumente të cilat i ka vënë në dispozicion më parë dhe nuk kanë ndryshime. Komisioneri Qendror i Zgjedhjeve miraton me Urdhër procedurat e ruajtjes dhe përditësimit të informacionit që mban IVJ.
- 10) Jo më vonë se 45 ditë përpara datës së zgjedhjeve KQZ e dërgon IVJ-në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC).
- 11) DPGJC harton listën e zgjedhësve sipas përcaktimeve të nenit 56 të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, duke hequr nga kjo listë emrat e atyre personave që përmban IVJ.
- 12) DPGjC harton listën e zgjedhësve nga jashtë vendit sipas përcaktimeve të nenit 46, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
- 13) Subjektet zgjedhore të regjistruara në këto zgjedhje në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, mund të marrin nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe/ose Komisioni Qendror i Zgjedhjeve një kopje elektronike të listave të zgjedhësve nga jashtë vendit.
- 14) Në rastin kur kërkesa për regjistrim është pranuar, atëherë KQZ njofton votuesin nga jashtë se ai do të hiqet nga lista e zgjedhësve të cilët votojnë brenda territorit të RSH dhe se do të pajiset me fletë votimi për të votuar atje ku ai ka vendbanimin.
- 15) Në rastin e zgjedhjeve të parakohshme procedura për paraqitjen e kërkesave për regjistrimin e votuesve nga jashtë fillon jo më vonë se 2 ditë nga data e shpalljes së dekretit të Presidentit të Republikës për caktimin e datës për zgjedhjet për Kuvendin dhe përfundon jo më vonë se 15 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

- 16) Përfaqësuesit e partive politike në KQZ, kanë të drejtën të njihen paraprakisht me të gjitha sistemet dhe/ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që sigurojnë procesin e regjistrimit të votuesve nga jashtë sipas parashikimeve të këtij vendimi.
- 17) Sistemet dhe pajisjet e teknologjisë së informacionit të përdorura për qëllime të zbatimit të këtij vendimi i nënshtrohen një testimi paraprak në prani të partive politike, medias dhe organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, etj.
- 18) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të KQZ.
- 19) Kundër këtij vendimi mundet të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, brenda (5) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
-

Ilirjana NANO **Kryetar**

Arens ÇELA **Anëtar**

Dritan ÇAKA **Anëtar**

Helga VUKAJ **Anëtar**

Muharrem ÇAKAJ **Anëtar**

